



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA MEMALIAJ

Data:22.11.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion i rruges ne fshatin Tosk -Martalloz”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): hekur -
14711000-8**

VLERA E FONDIT LIMIT:

**1.325.290 (nje million e treqind e njetzet e pese mije e dyqind e nentedhjetë) lek pa
TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Memaliaj** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i Ofertës sipas shtojcës 1 dhe 2*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme).

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001 : 2018 ose ekuivalente (e vlefshme). .

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punëve që do të marr përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes. Në bazë të pikës 1, nenit 45, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate.

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikatën të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme .

ISO 45001:2018 “Sistemi imenaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë

Argumentimi: Në bazë të pikës 1, nenit 45, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar dhe të vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, sipas objektit të kësaj kontrate. Kjo certifikatë përfaqëson pikën e referimit, e njohur në nivel botëror, për certifikimin e cilësisë së menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë të cilësisë së bizneseve të gjithë sektorëve dhe të gjitha përmasave.

Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime të zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve. Kjo certifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi, kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë

të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, gjeodet, mekanik dhe hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1, nenit 45, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenin 79 të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” është tepër e rëndësishme që operatorët ekonomik ofertues si zbatues të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të mjedisit, të cilët janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor.

ISO 39001:2012 “Sistemi i menaxhimit të trafikut rrugor”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.**

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontrates.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

1.1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
- Fatura tatimore të situacionit përfundimtar

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;

Fatura tatimore të situacionit përfundimtar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës së fondit limit që prokurohet për punët

totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

-

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën Profesionale të Shoqërisë, për realizimin e punimeve, të lëshuar nga autoritetet kompetente Shtetërore, sipas modelit MPPT/MTI në kategoritë:

NP- 4 A

Kategoria NP-4 – A	Rruge,autostrada,mbikalime,hekur udha,tramvajiPërfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, parkimet, sheshet të realizuara me material të veçanta, natyrale dhe artificiale etj	/Punime shtresash ne rruge te gjithë zerat.	A	(21 - 50 milion lekë
-----------------------	---	---	---	----------------------

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategorite dhe nivelet e licencave te kerkuara jane bazuar ne Lidhjen 3 dhe 4 te VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”

Kategoria e përcaktuar “A” për secilën licencë të kërkuar është bërë sipas vlerave në lekë (0- 20 milion lekë) të punimeve të kryera për çdo kategori punimi,

- Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

3. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 10 punonjës në fushën e ndërtimit të siguruar për periudhën korrik 2023 – shtator 2023.Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë: (sipas grafikut te punimeve). 4. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik ose Përgjegjës Teknik kantieri shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- ii. Libreze pune
- iii. Kontrate pune e vlefshme

iv. Diplome

5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune të përfshirë në listpagesa për korrik 2023 – shtator 2023.

- Inxhinier Ndertimi (1) nje

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve është përcaktuar referuar volumeve të punës që do të kryhen, afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi, si dhe grafikut të punimeve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Është vendosur ky numër punonjësish referuar zërave të punës që do të kryhen sipas preventivit dhe si dhe afatit të përfundimit të punimeve të parashikuar si dhe referuar VKM Nr. 629, date 15.07.2015 ”Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike të tyre” janë mbedhur të gjithë orët e punës të puntorisë për të gjithë zerrat e punimeve duke përcaktuar specifikisht numurin e punonjësve.

6. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojitet për ekzekutimin e kontratës.

LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA
Kamion deri në 8 ton	Ne pronesi ose me qera	1 cope
Rrul me vibrim	Ne pronesi ose me qera	1 cope
Kamiocine deri në 3.5 ton	Ne pronesi ose me qera	1 cope
Eskavator	Ne pronesi ose me qera	1 cope

- Operatori Ekonomik të paraqesë deklaratën sipas shtojcës Nr.10.*
- Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe*

siguracionin e mjetit, dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, si dhe lejen e transportit nga institucionet perkates.

- c) Per automjetet qe nuk shenohen ne rregjistra publike ,duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine e tyre.*
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje ne çdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknike*
- e) Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera, (Deklarate nga Administratori i Shoqerise Ofertuese).*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Specifikimet teknike janë vendosur në bazë nenit 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Specifikimet teknike gjenden në DST, në SPE

Njesia e Prokurimit

Xhuvana Kuçi

Bujar Kapllani

Violeta Kanushi